

IDENTIFIKIMI I
PROBLEMEVE KRYESORE
ME TË CILAT PËRBALLET
KOMUNITETI FARMACEUTIK

RAPORT
2019



IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE KRYESORE ME TË
CILAT PËRBALLET KOMUNITETI FARMACEUTIK

RAPORT
2019

KOMISIONI I ODËS SË FARMACISTËVE TË
KOSOVËS PËR BARNATORE KOMUNITARE



REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

Komora Farmaceuta Kosova

Kosova Chamber of Pharmacists

**Komisioni i Odës së Farmacistëve të Kosovës
për Barnatore Komunitare**

**IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE KRYESORE ME TË CILAT
PËRBALLET KOMUNITETI FARMACEUTIK**

Raport

Prishtinë, 2019

ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

Komisioni i Odës së Farmacistëve të Kosovës për Barnatore Komunitare

Autorë:

Mr. ph. Shkumbin Jusufi

Mr. ph. Visar Ademi

Mr. ph. Alban Desku

Mr. ph. Besim Azemi

Falënderojmë kryetarin e Odës së farmacistëve të Kosovës, z. Arianit Jakupi për këshillat e çmuara profesionale rreth kompletimit të këtij projekti.

Falënderojmë farmacistin klinik z. Visar Emini për këshillat e tij të vlefshme rreth realizimit dhe kompletimit të këtij raporti.

Falënderojmë të gjithë farmacistët që iu kanë përgjigjur iniciativës tonë për ndihmën e ofruar në mbledhjen e të dhënave për realizimin e këtij raporti.

Raporti që po merrni në dorë ka vertet autoresinë tonë, por nuk është vetëm i joni. Është një hulumtim që ka përfshirë shumë kolegë farmacistë të cilët na ndihmuan në grumbullimin e të dhënave.

Të gjithëve: Mirënjohje!



Përmbajtja

I. Hyrje	13
Komisioni për Barnatore Komunitare i Odës së Farmacistëve të Kosovës	13
Barnatoret Komunitare	15
II. Qëllimi i punimit	17Δ
III. Materiali dhe metodat	18
IV. Rezultatet	19
V. Diskutimi	41
VI. Përfundimet	45
VII. Referencat	48
VIII. Shtojca 1 – Anketa	50



Shkurtesat:

MSH	Ministria e Shëndetësisë
OFK	Oda e Farmacistëve të Kosovës
MEF	Ministria e Financave
FSSH	Fondi për Sigurime Shëndetësore
AKPPM	Agjensioni Kosovar për Produkte dhe Paisje Mjekësore
IF	Inspektorati Farmaceutik
OBSh	Organizata Botërore e Shëndetësisë
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
SHSKUK	Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
SHFK	Shoqata e Farmacistëve të Kosovës



Rezyme

Momentalisht në Kosovë operojne 644 barnatore të licencuara (AKPPM 2019) të cilat janë të shpërndara në të gjithë territorin.

Mungesa e barnave të regjistruara në sektorin farmaceutik të Kosovës është një nga problemet, me të cilat ballafaqohen jo vetëm farmacistët por edhe qytetarët. Si rrjedhojë, qytetarët përballen me mungesë të barnave që i përdorin si terapi ditore.

Ndryshe, barnat nëpër barnatoret e Kosovës, nuk kanë çmime të unifikuara. Kjo, sipas zyrtarëve institucionalë, ndodh për shkak se Kosova nuk e ka një rregullore administrative që do të mund ta rregullonte këtë çështje. Ata thonë se laramania e çmimeve nëpër barnatore është evidente dhe një gjë e tillë ndodh për shkak të tregut të lirë që ekziston në Kosovë.

Përfaqësuesit e organizatave që mbrojnë interesat e farmacistëve (OFK dhe SHFK), kanë deklaruar se laramania e çmimeve e destabilizon tregun farmaceutik, andaj, sipas tyre, kjo çështje duhet rregulluar sa më shpejt.

Rezultatet e fituara në hulumtimin tone tregojnë për rëndësinë e madhe të problemeve aktuale që shqetësojnë farmacistë në përgjithësi dhe sidomos farmacistët e barnatoreve komunitare në veçanti. Analiza kualitative e përgjigjeve të farmacistëve të marra përmes pyetësorit i cili është përgatitur nga Komisioni për Barnatoret Komunitare tregon për një racionalitet sa i përket rëndësisë së problemeve aktuale me të cilat përballen farmacistët në punën e përditshme të tyre në barnatore.

Megjithatë, nëse analizojmë një nga një përgjigjet e farmacistëve, vërejmë se problemet e tyre janë relativisht të madha, duke filluar nga problemet me licencimin e barnatoreve, titullari i pronës së barnatores, distance në mes të barnatoreve, nevoja për barna të reja si dhe shqetësimi kryesor ai i çmimit zyrtar të barnave (çmimi në banderolë).

Studimi jonë tregon se çmimi zyrtar i produkteve medicinale (çmimi në banderolë) është i domosdoshëm. Shumica absolute e farmacistëve janë shprehur pozitivisht për çmimin në banderolë të produkteve farmaceutike.

Misioni i Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK-së) është profesionalizmi dhe siguria e përdorimit të barnave.

Komisioni për Barnatore Komunitare është organ i Odës së Farmacistëve të Kosovës i cili përfaqëson dhe mbron interesat e barnatoreve komunitare.



I. Hyrje

Komisioni për Barnatore Komunitare i Odës së Farmacistëve të Kosovës

Oda e Farmacistëve të Kosovës në bazë të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe Statutit të Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK) është organizatë e pavarur e cila mbron dhe prezanton interesat profesionale të anëtarëve të saj, siguron standardet e larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Misioni i Odës së Farmacistëve të Kosovës është profesionalizmi dhe siguria e përdorimit të barnave, e cila këtë mision synon që ta përmbushë në bazë të punës së këshillave dhe komisioneve të cilat ushtrojnë veprimtarinë e tyre sipas rregullave të përcaktuara. Një nga këto komisione është edhe komisioni për Barnatore Komunitare si organ i OFK i cili përfaqëson dhe mbron interesat e barnatoreve komunitare dhe i përcaktur sipas nenit 53 të statutit të OFK.

Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës është e përkushtuar për një sistem shëndetësor unik dhe funksional ku në qendër të vëmendjes është pacienti dhe të drejtat e tij për shërbime sa më cilësore shëndetësore. Në kuadër të këtij synimi, rëndësi e veçantë i kushtohet edhe sektorit të Farmacisë.



Barnatoret Komunitare

Një nga objektivat kryesore të barnatoreve komunitare është ofrimi i barnave dhe materialit medicinal shoqëruar me keshillat profesionale nga farmacistët komunitar për qytetarër në nevojë. Kurse një nga detyrat të cilat duhet realizuar për tu arritur ky objektivi është edhe furnizimi adekuat me barna dhe material shpenzues medicinal të nevojshëm për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Momentalisht në Kosovë operojnë 644 barnatore të cilat janë të shpërndara në të gjithë territorin.

Mungesa e barnave të regjistruara në tregun farmaceutik të Kosovës është një nga problemet, me të cilat ballafaqohen jo vetëm farmacistët por edhe qytetarët. Si rrjedhojë, qytetarët përballen me mungesë të barnave që i përdorin si terapi ditore.

Ndryshe, barnat nëpër barnatoret e Kosovës, nuk kanë çmime të unifikuara. Kjo, sipas zyrtarëve institucionalë, ndodh për shkak se Kosova nuk e ka një rregullore administrative që do të mund ta rregullonte këtë çështje. Ata thonë se laramania e çmimeve nëpër barnatore është evidente dhe një gjë e tillë ndodh për shkak të tregut të lirë që ekziston në Kosovë.

Përfaqësuesit e organizatave që mbrojnë interesat e farmacistëve (OFK dhe SHFK), kanë deklaruar se laramania e çmimeve e destabilizon tregun farmaceutik, andaj, sipas tyre, kjo çështje duhet rregulluar sa më shpejt. Takime dhe debate janë zhvilluar disa herë për çështjen e çmimit të barnave dhe blerjen e tyre jo vetëm nga qytetarët por edhe nga Ministria e Shëndetësisë me çmim më të shtrenjtë disa herë se çmimi real i tyre në treg.

Ministria e Shëndetësisë është në proces të hartimit të udhëzimit administrativ për çmimet e barnave, me ç'rast do të ketë kontroll mbi çmimet e barnave. Drafti i parë i udhëzimit administrativ, tashmë ka përfunduar dhe ky është bërë në përputhje me rekomandimet nga Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Synimi është që të krijohet kontrolli i çmimeve përmes çmimeve referente nga shtetet e rajonit, duke mos lejuar që diferencat në çmime për të njëjtat produkte të jenë shumëfish më të larta se në rajon.

Duke marrë parasysh buxhetin cili i ndahet MSH-së nga MEF të shprehur në përqindje të GDP-së së vendit, Kosova bën pjesë në vendet me përqindjen më të ultë të buxhetit për shëndetësi, rreth 3% e GDP (World Bank 2019), krahasuar me shtetet e rajonit 5-7% e GDP apo me shtetet evropiane 10% e GDP që përbëjnë buxhetin për shëndetësi.

Duke marrë parasysh të dhënat buxhetore mund të shohim se buxheti i alokuar për Shëndetësi është jashtëzakonisht i ulët krahasuar me GDP si dhe me ndarjen e buxhetit në rajon dhe Evropë.

Kuvendi i Kosovës ka miratuar në vitin 2013 Ligjin për Sigurimet Shëndetësore në Kosovë (Ligji 04-L-249) me qëllim të sigurimit të qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të indikatorëve shëndetësor dhe sigurimit të mbrojtjes financiare nga varfërimi për shkak të shpenzimeve të mëdha për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor. Ky ligj rregullon themelimin, organizimin, funksionimin, dhe financimin e sistemit publik të sigurimeve shëndetësore; si dhe të drejtat dhe obligimet e palëve të përfshira.

Ministria e Shëndetësisë në kuadër të saj ka themeluar Fondin për Sigurime Shëndetësore (FSSH). Mirëpo ky institucion ende nuk funksionon si i plotë me të gjitha kapacitetet e tij, ende nuk ka filluar me reimbursimin e barnave që blehen nga qytetarët nëpër barnatoret komunitare.

Vështirësitë tjera që farmacistët kanë gjatë punës së tyre të përditshme janë edhe ato që kanë të bëjnë me institucionet shëndetësore si dhe ndërvarësisë dhe obligimeve ndaj tyre. Vështirsia kryesore që ka të bëjë me AKPPM-në dhe që theksohet nga farmacistët është lartësia e taksës vjetore për akreditimi vjetor që duhet paguar çdo vit dhe që paraqet një barrë financiare për barnatoret komunitare.

Jo më pak të rëndësishme janë edhe vështirësitë e karakterit ligjor dhe administrativ siç janë: pronësia e barnatorës, sipërfaqja e barantores, numri i farmacistve që duhet të jetë i punësuar në një barnatore komunitare, asgjësimi i barnave të skaduara, mungesa e recetës për barna psikotrope dhe narkotike, furnizimi nga depot farmaceutike etj.

II. Qëllimi i punimit

Duke konsideruar se problemet e farmacistëve në përgjithësi dhe të farmacistëve të barnatoreve komunitare në veçanti janë me rëndësi në sistemin e përkujdesjes shëndetësore të popullatës, duhet që organet e politikëbërjes dhe ato ekzekutive të merren me zgjidhjen e tyre sa më parë.

Farmacistët e Republikës së Kosovës përballen me një sërë problemesh për një kohë të gjatë. Duke konsideruar se numri i vështirësive që përballen farmacistët është i madh, ne kemi planifikuar analizën e problemeve më të rëndësishme në mënyrë që të bëhet vetëdijësimi i institucioneve shëndetësore të cilat kanë për obligim që të sanojnë këto vështirësi dhe të krijojnë lehtësira ligjore dhe administrative jo vetëm kundrejt farmacistëve por edhe në raport me qytetarët në përgjithësi.

Ky hulumtim, për herë të parë do të vendosë në fokus problemet e farmacistëve dhe reflektimin e tyre në mbrojtjen shëndetësore të pacientëve dhe do të elaborohet roli i tyre në cilësinë e ofrimit të shërbimeve shëndetësore.

Hulumtimi është strukturuar me qëllim të analizës së përgjigjeve të farmacistëve që shërbejnë nëpër barnatoret Republikës së Kosovës, me theks të veçantë në analizën e problemeve aktuale me të cilat ballafaqohet komuniteti i farmacistëve në barnatoret komunitare.

Qëllimet e hulumtimit kanë qenë:

1. Analiza e strukturës së shërbimeve të institucioneve shëndetësore për të cilat kanë nevojë barnatoret komunitare.
2. Analiza kuantitative e strukturës së njohurive që kanë farmacistët rreth paketës ligjore që ka të bëjë me punën e tyre të përditshme.
3. Evidentimi i problemeve me të cilat ballafaqohen farmacistët e barnatoreve komunitare.

III. Materiali dhe metodat

Hulumtimi karakterizohet në grupin e hulumtimeve me pyetësor i cili përbëhet prej 20 pyetjeve. Ky studim është prospektiv dhe është realizuar me farmacistët pjesmarrës në konferencën vjetore farmaceutike të organizuar nga OFK e cila është mbajtur me datë 16 dhe 17 nëntor 2018 në Prishtinë.

Popullsia në shënjestër dhe zgjedhja e mostrës;

Në studim janë përfshirë 311 farmacistë të moshave të ndryshme me eksperiencë profesionale nga 0-40 vjeçare dhe me origjinë nga të gjitha trevat e Kosovës.

Pyetësori dhe anketimi;

Teknika e anketimit ka përfshirë pyetje të strukturuar me disa përgjigje, ku të farmacistët e anketuarit kanë zgjedhur përgjigjen më të përshtatshme për ta. Të gjitha anketimet janë bërë me dëshirën e të anketuarve dhe është ruajtur konfidencialiteti duke ruajtur identitetin e farmacistëve.

Të dhënat e grumbulluara janë vendosur në një databazë në programin EXCEL, të cilat janë përpunuar dhe pas analizës së tyre, kemi fituar të dhënat e nevojshme.

IV. Rezultatet

Në periudhën e grumbullimit të të dhënave gjatë hulumtimit tonë, kemi analizuar të dhënat për 311 farmacistë. Rezultatet i kemi prezentuar në formë grafikoni, kryesisht në formë të strukturës së përqindjes.

A JENI TË KËNAQUR ME SHËRBIMET E OFRUARA NGA OFK?




Figura nr.1. (n= 311 farmacistë)

Nga 311 farmacistë pjesëmarrës në anketimin e mbajtur, në pyetjen se 'A jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara nga Oda e Farmacistëve të Kosovës?', 26.37% kanë dhënë përgjigje negative, ndërsa 73.63% kanë dhënë përgjigje pozitive.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një dallim të dukshëm në aspektin pozitiv sa i përket shërbimeve të ofruara nga OFK.

A JENI TË KËNAQUR ME SHËRBIMET E OFRUARA NGA AKPPM?




Figura nr. 2. (n-311 farmacistë)

Në figurën nr. 2 kemi analizuar përmbushjen e pritshmërive të farmacistëve nga shërbimet e Agjencionit Kosovar për Produkte dhe Paisje Medicinale. Në këtë figurë kemi paraqitur ndarjen farmacistëve sa i përket shërbimeve të ofruara nga AKPPM, ku në pyetjen se 'A jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara nga AKPPM?', 34.72% kanë dhënë përgjigje pozitive, ndërsa pjesa më madhe 65.27% kanë dhënë përgjigje negative.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një dallim të dukshëm në aspektin negativ sa i përket shërbimeve të ofruara nga AKPPM.

A JENI TË KNAQUR ME SHËRBIMET E OFRUARA NGA MSH (MINISTRIA E SHËNDETËSISË), GJEGJËSISHT ME PUNËN E INSPEKTORIATIT FARMACEUTIK (IF)?




Figura nr. 3. (n= 311 farmacistë)

Në figurën nr. 3 kemi analizuar performancën e përkujdesjes së Ministrisë së Shëndetësisë respektivisht Inspektoratit Farmaceutik (IF) karshi barnatoreve komunitare.

Dallimi në përgjigjet e dhëna nga farmacistët është i vogël, ku në pyetjen se 'A jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara nga MSH, gjegjësisht me punën e IF?', 46.30% kanë dhënë përgjigje negative, ndërsa 53.69% kanë dhënë përgjigje pozitive.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një kënaqësi relativisht të dukshme të farmacistëve sa i përket shërbimeve të ofruara nga MSH/IF.

A JU PARAQESIN VËSHTIRËSI PROCEDURAT E LICENCIMIT TË BARANTOREVE KOMUNITARE NGA ORGANET KOMPETENTE TË AKPPM-SË?




Figura nr. 4.1. (n-311 farmacistë)

Në figurën nr. 4.1. kemi analizuar vështirësitë që hasin farmacistët në procedurat e licencimit në AKPPM. Në këtë figurë kemi paraqitur mendimin e farmacistëve sa i përket vështirësive gjatë procesit të licencimit të barnatoreve të tyre, ku në pyetjen se 'A ju paraqesin vështirësi procedurat e licencimit të barantoreve komunitare nga organet kompetente të AKPPM-së?', 36.3% kanë dhënë përgjigje negative, ndërsa 63.67% kanë dhënë përgjigje pozitive.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një dallim të dukshëm sa i përket vështirësive gjatë procesit të licencimit të barnatoreve, një pjesë e konsiderueshme e farmacistëve (198) janë përgjigjur se kanë vështirësi gjatë licencimit të barnatoreve në AKPPM.

NËSE PO, NË CILAT PROCEDURA MENDONI SE KENI VESHTIRËSI GJATË LICENCIMIT?




Figura nr.4.2. (n-198 farmacistë)

Në figurën nr. 4.2. kemi analizuar strukturën e përgjigjeve të farmacistëve që kanë pohuar se kanë vështirësi gjatë licencimit të barnatoreve në AKPPM. Nga 198 farmacistë, 25.75% e tyre mendojnë se vështirësi për licencimin e barnatorës është 'Hapsira e lokalit (p.sh. sipërfaqja, lartësia); 31.31% e farmacistëve mendojnë se vështirësi për licencimin e barnatorës është 'Dëshmia e pronësisë së lokalit (kontrata qiramarrje/qiradhënie)'; ndërsa pjesa më e madhe e farmacistëve 42.49% mendon se vështirësi për licencimin e barnatorës është 'Lartësia e taksës vjetore, akreditimi vjetor'.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një ndarje pothuajse të barabartë në lidhje vështirësitë gjatë procesit të licencimit të barnatoreve në AKPPM.

A MENDONI SE PEZULLIMI I LICENCËS SË BARNATORES NGA ANA E ORGANEVE TË AKPPM-SË ËSHTË I DREJTË PËRSHKAK TË VONESËS SË APIKIMIT PËR VETËM EDHE NJË DITË?




Figura nr.5. (n-309 farmacistë)

Në këtë figurë kemi prezentuar strukturën përgjigjeve të farmacistëve se a duhet pezulluar licenca e barnatores nga ana e AKPPM-së përshkak të vonesës së aplikimit, qoftë edhe për një ditë.

Shumica e farmacistëve 75.73% kanë dhënë përgjigje negative, se nuk duhet pezulluar licenca e barnatores për vonesë të vogël kohore të aplikimit, ndërsa 24.27 e farmacistëve kanë dhënë përgjigje pozitive sa i përket pezullimit të licences nëse vonohet aplikimi, qoftë edhe një ditë.

A JENI TË KËNAQUR ME KRITERET E PËRCAKTUAR SIPAS UDHËZIMIT ADMINISTRATIV 11/2015 NË LIDHJE ME LICENCIMIN E BARNATOREVE KOMUNITARE?




Figura nr.6. (n-306 farmacistë)

Në figurën 6 kemi analizuar strukturën e përgjigjeve të farmacistëve në pyetjen se: 'A jeni të kënaqur me kriteret e përcaktuar sipas Udhëzimit administrativ 11/2015 në lidhje me licencimin e barnatoreve komunitare?'. Nga 306 farmacistë që kanë dhënë përgjigje, 55.88% e tyre kanë dhënë përgjigje negative dhe 44.12% e farmacistëve janë të kënaqur me kriteret e përcaktuara sipas Udhëzimit administrative 11/20015 në lidhje me licencimin e barnatoreve komunitare.

A MENDONI SE PRONAR I BARNATORES KOMUNITARE DUHET TË JETË VETËM FARMACISTI?




Figura nr. 7. (n-307 farmacistë)

Siç vërehet nga figura nr. 7, shumica dërmuese e farmacistëve 83.06% kanë dhënë përgjigje pozitive në pyetjen se 'A mendoni se pronar i barnatores komunitare duhet të jetë vetëm farmacisti?' ndërsa vetëm 16.94% e tyre kanë dhënë përgjigje negative në këtë pyetje.

A MENDONI SE DUHET TË JETË NJË DISTANCË E CAKTUAR ME LIGJ (UDHËZIM ADMINISTRATIV) SI KRITER PËR LICENCIMIN E BARNATOREVE KOMUNITARE?




Figura nr. 8.1. (n-307 farmacistë)

Nga kjo figurë mund të vlerësojmë se nga grupi i 307 farmacistëve ka dominuar përgjigjja pozitive me 89.25% në pyetjen se 'A mendoni se duhet të jetë një distancë e caktuar me ligj (Udhëzim Administrativ) si kriter për licencimin e Barnatoreve Komunitare?', ndërsa vetëm 10.75% e farmacistëve pjesëmarrës në hulumtim kanë dhënë përgjigje negative në këtë pyetje.

NËSE PO, SA MENDONI SE DUHET TË JETË DISTANCE NGA BARNATORET EKZISTUESE?




Figura nr. 8.2. (n-274 farmacistë)

Në figurën nr. 8.2. kemi analizuar strukturën e përgjigjeve të farmacistëve që kanë pohuar se duhet të ketë distance nga barnatoret ekzistuese si kriter gjatë licencimit të barnatores së re. Nga 274 farmacistë që kanë pohuar se duhet të jetë kriteri i distancës, 24.45% e tyre mendojnë se kjo distance duhet të jetë 100 m; 30.66% e tyre kanë dhënë përgjigje se kjo distance duhet të jetë 300 m; ndërsa pjesa më e madhe e farmacistëve 44.89% mendon se kjo distance duhet të jetë 500 m.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon se dominon mendimi që distance në mes të barnatoreve komunitare të jetë të paktën 500 m.

A KENI NJOHURI PËR UDHËZIMIN ADMINISTRATIV PËR IMPORTIN E PRODUKTEVE JOPARALELE TË REGJISTRUARA NË KOSOVË?




Figura nr. 9. (n-306 farmacistë)

Nga kjo figurë mund të vlerësojmë se nga grupi i 306 farmacistëve ka dominuar përgjigjja negative me 67.32% në pyetjen se 'A keni njohuri për udhëzimin administrativ për importin e produkteve joparalele të regjistruara në Kosovë?', ndërsa vetëm 32.68% e farmacistëve pjesmarrës në hulumtim kanë dhënë përgjigje pozitive në këtë pyetje.

A MENDONI SE BARNAT E REGJISTRUARA NË KOSOVË I PËRMBUSHIN NEVOJAT E TREGUT?




Figura nr.10 (n-305 farmacistë)

Siç vërehet nga figura nr. 10, shumica dërmuese e farmacistëve 77.70% kanë dhënë përgjigje negative në pyetjen se 'A mendoni se barnat e regjistruara në Kosovë i përmbushin nevojat e tregut?', ndërsa vetëm 22.30% e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive në këtë pyetje.

A MENDONI SE KRITER PËR LICENCIMIN E BARNATOREVE KOMUNITARE DUHET TË JENË 2 FARAMCISTË?




Figura nr. 11. (n-311 farmacistë)

Në figurën nr. 11 kemi analizuar si si duhethet të jetë stafi profesional i barnatoreve komunitare. Në këtë figurë kemi paraqitur ndarjen farmacistëve sa i përket pyetjes se 'A mendoni se kriter për licencimin e barnatoreve komunitare duhet të jenë 2 farmacistë?'. 37.62% kanë dhënë përgjigje negative, ndërsa 62.38% kanë dhënë përgjigje pozitive.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një dallim të dukshëm në aspektin pozitiv sa i përket numrit të farmacistëve që duhet t'i ketë një barnatore.

A MENDONI SE KRITER PËR LICENCIMIN E BARNATOREVE KOMUNITARE DUHET TË JETË TEKNIKU I FARMACISË?




Figura nr. 12. (n-311 farmacistë)

Siç vërehet nga figura nr. 12, farmacistet të cilët kanë marrë pjesë në hulumtim kanë mendim të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë sa i përket pyetjes se 'A mendoni se kriter për licencimin e barnatoreve komunitare duhet të jetë tekniku i farmacisë?', ku 49.20% e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive ndërsa 50.80% e tyre kanë dhënë përgjigje negative në lidhje me domosdoshmërinë e teknikut të farmacisë gjatë licencimit të barnatores.

A MENDONI SE DUHET TË KETË ÇMIM ZYRTAR TE PRODUKTEVE MEDICINALE (ÇMIMI NË BANDEROLË)?




Figura nr. 13. (n-311 farmacistë)

Në figurën nr. 13 kemi analizuar përgjigjet e farmacistëve në pyetjen se 'A mendoni se duhet të ketë çmim zyrtar te produkteve medicinale (çmimi në banderolë)?'

Dallimi në përgjigjet e dhëna nga farmacistët është i dukshëm, ku 87.78% kanë dhënë përgjigje pozitive, ndërsa vetëm 12.22% kanë dhënë përgjigje negative.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një interes pothuajse absolut të farmacistëve që barnat të kenë çmim zyrtar (çmimi në banderolë).

A KENI ASGJËSUAR BARNA ME AFAT TË SKADUAR?




Figura nr. 14. (n-311 farmacistë)

Siç vërehet nga figura nr. 14, shumica dërmuese e farmacistëve 81.99% kanë dhënë përgjigje negative në pyetjen se 'A keni asgjësuar barna me afat të skaduar?', ndërsa vetëm 18.01% e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive në këtë pyetje.

Nga kjo strukturë e përgjigjeve të farmacistëve që kanë marrë pjesë në hulumtim shihet se një numër i madhë i farmacistëve në Kosovë nuk kanë asgjësuar barna.

A JENI TË INFORMUAR ME PROCEDURAT E ASGJËSIMIT TË BARNAVE ME AFAT TË SKADUAR?




Figura nr. 15. (n-303 farmacistë)

Në figurën nr. 15 kemi analizuar përgjigjet e farmacistëve në pyetjen se 'A jeni të informuar me procedurat e asgjësimit të barnave me afat të skaduar?'.

Pjesa më e madhe e farmacistëve, 69.97% e tyre ka treguar se nuk janë të informuar me procedurat e asgjësimit të barnave, ndërsa vetëm 30.03% kanë dhënë përgjigje positive në këtë pyetje.

GJATË PUNËS PROFESIONALE NË BARNATORE, CILAT NGA PROBLEMET JU SHQETËSOJNË?




Figura nr. 16. (n-310 farmacistë)

Në figurën nr.16 kemi analizuar problemet më të shpeshta që shqetësojnë farmacistët e barnatoreve komunitare. 25.16% e farmacistëve që kanë marrë pjesë në hulumtim kanë dhënë përgjigje se 'Mungesa e recetës' është shqetësim në punën e përditshme të tyre në barnatore; 26.45% kanë dhënë përgjigje për opsionin 'Mungesa e barnave', ndërsa pjesa më e madhe e farmacistëve prej 48.39% ka si shqetësim kryesor 'Çmimet jostabile të barnave' gjatë punës së përditshme në barnatoret komunitare.

Kjo strukturë e përgjigjeve tregon për një pakënaqësi relativisht të dukshme të farmacistëve sa i përket çmimeve jostabile të barnave.

GJATË PUNËS PROFESIONALE NË BARNATORE, A JU PARAQET PROBLEM MUNGESA E RECETËS PËR PSIKOTROPE DHE NARKOTIK?




Figura nr. 17. (n-311 farmacistë)

Siç vërehet nga figura nr. 17, shumica dërmuese e farmacistëve 90.35% kanë dhënë përgjigje pozitive në pyetjen se 'Gjatë punës profesionale në barnatore, a ju paraqet problem mungesa e recetës për psikotrope dhe narkotik?', ndërsa vetëm 9.65% e tyre kanë dhënë përgjigje negative në këtë pyetje.

Nga kjo strukturë e përgjigjeve të farmacistëve që kanë marrë pjesë në hulumtim shihet në numër pothuajse absolut i farmacistëve që e kanë si problem mungesën e recetës barnat psikotrope dhe narkotike.

A JENI TË KËNAQUR ME SHËRBIMET E OFRUARA NGA DEPOT FARMACEUTIKE?




Figura nr. 18. (n-311 farmacistë)

Siç vërehet nga figura nr. 18, farmacistet të cilët kanë marrë pjesë në hulumtim kanë mendim të ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë sa i përket pyetjes se 'A jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara nga depot farmaceutike?', ku 48.23% e tyre kanë dhënë përgjigje negative ndërsa 51.77% e tyre kanë dhënë përgjigje pozitive në lidhje me plotësimin e nevojave dhe kërkesave nga depot farmaceutike.

KUSH MENDONI SE DUHET TË JETË PËRGJEGJËS PËR LICENCIMIN E BARNATOREVE KOMUNITARE?




Figura nr. 19. (n-311 farmacistë)

Në figurën nr. 19 kemi analizuar përgjigjet e farmacistëve në pyetjen se 'Kush mendoni se duhet të jetë përgjegjës për licencimin e barnatoreve komunitare?'.

Pjesa më e madhe e farmacistëve, 71.06% e tyre mendojnë se OFK duhet të merret me licencimin e barnatoreve komunitare, ndërsa vetëm 28.94% mendojnë se AKPPM duhet të merret me licencimin e barnatoreve komunitare.

A MENDONI SE KY PYETËSOR I KA PËRFSHIRË NË MËNYRË TË KËNAQSHME PROBLEMET AKTUALE ME TË CILAT PËRBALLET SOT KOMUNITETI FARMACEUTIK (BARNATORET KOMUNITARE)?




Figura nr. 20. (n-307 farmacistë)

Siç vërehet nga figura nr. 20, shumica e farmacistëve 79.15% kanë dhënë përgjigje pozitive në pyetjen se 'A mendoni se ky pyetësor i ka përfshirë në mënyrë të kënaqshme problemet aktuale me të cilat përballet sot komuniteti farmaceutik (Barnatoret Komunitare)?', ndërsa vetëm 20.85% e tyre kanë dhënë përgjigje negative në këtë pyetje.

Nga kjo strukturë e përgjigjeve të farmacistëve që kanë marrë pjesë në hulumtim shihet se një numër i madhë i farmacistëve në Kosovë mendon se problemet që janë cekur në këtë hulumtim janë shqetësimet aktuale me të cilat përballet sot komuniteti farmaceutik (Barnatoret Komunitare).

V. Diskutimi

Rezultatet e fituara tregojnë për rëndësinë e madhe të problemeve aktuale që shqetësojnë farmacistë në përgjithësi dhe sidomos farmacistët e barnatoreve komunitare në veçanti. Analiza kualitative e përgjigjeve të farmacistëve të marra përmes pyetësorit i cili është përgatitur nga Komisioni për Barnatoret Komunitare tregon për një racionalitet sa i përket rëndësisë së problemeve aktuale me të cilat perballen farmacistët në punën e përditshme të tyre në barnatore.

Megjithatë, nëse analizojmë një nga një përgjigjet e farmacistëve, vërejmë se problemet e tyre janë relativisht të madha, duke filluar nga problemet me licencimin i barnatoreve, titullari i pronës së barnatores, distance në mes të barnatoreve, nevoja për barna të reja si dhe shqetësimi kryesor ai i çmimit zyrtar të barnave (çmimi në banderole). Sipas Ligjit për produkte dhe pajisje medicinale (L 04/190), Neni 38, rregullimi i çmimit të produkteve dhe pajisjeve medicinal dhe caktimi i marzhave për produkte dhe pajisje medicinal bëhet nga AKPPM dhe MSH. Pra, Neni 38 i ligjit të sipërpërmendur është në përputhshmëri me kapitullin e IX të Kushtetutës së Rpublikës së Kosovës i cili përcakton marrëdhëniet ekonomike ku specifikohet sipas Nenit 119 (Parimet e përgjithshme), pika 3: veprimet që kufizojnë konkurrencën e lire perms vendosjes ose abuzimit të pozitës dominuese, ose praktikave që e kufizojnë konkurrencën, janë të ndaluara, me përjashtim kur këto lejohen në mënyrë eksplicite me ligj.

Nëse analizojmë pritjet e farmacistëve me shërbimet e ofruara nga OFK, vërejmë se pjesa më e madhe e tyre ka mendim pozitiv për këto shërbime dhe janë të kënaqur.

Këtu duhet pasur parasysh që Oda e Farmacistëve të Kosovës është një institucion që është themeluar relativisht vonë dhe ekziston që nga viti 2014, megjithatë ka arritur që të përmbushë me sukses një pjesë të madhe të kërkesave të farmacistëve.

Nuk mund të thuhet e njejta gjë për shërbimet e ofruara nga AKPPM për farmacistët të cilët kanë nevojë për këto shërbime. Rreth 2/3 e farmacistëve kanë shprehur pakënaqësi me shërbimet e AKPPM-së (megjithëse vlen të theksohet se prej anketimit në Nëntor 2018 dhe deri në përgatitjen e këtij publikimi Qershor 2019 ka pasur rezultate konkrete në përmirësimin e shërbimeve të ofruara).

Gjithashtu, edhe për shërbimet e ofruara nga MSH respektivisht Inspektorati Farmaceutik, shumica e të anketuarve janë shprehur pozitivisht.

Gjatë analizës së vështirësive në procedurat e licencimit të barantoreve komunitare nga organet kompetente të AKPPM-së, rreth 2/3 e farmacistëve pohojnë se këto vështirësi janë evidente. Vështirësia kryesore e cila theksohet nga pjesa më e madhe e farmacistëve është e karakterit ekonomik dhe që ka të bëjë më lartësinë e taksës vjetore apo akreditimin vjetorë. Si vështirësi të radhës përmenden edhe dëshmia e pronësisë së lokalit (kontrata qiramarrje/qiradhënie) si dhe hapsira e lokalit (p.sh. sipërfaqja, lartësia).

Shumica e farmacistëve kanë menduar se nuk duhet pezulluar licenca e barnatores për vonesë të vogël kohore të aplikimit sepse kjo shkaton procedura burokratike të panevojshme.

Sa i përket Udhëzimit administrativ 11/2015 në lidhje me licencimin e barnatoreve komunitare, mendimi i farmacistëve është i ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë ku pak më shumë se gjysma e farmacistëve nuk janë të kënaqur me kriteret e këtij udhëzimi për licencimin e barnatoreve komunitare ndërsa pjesa tjetër i konsiderojnë këto kriterë si të pranueshme.

Ashtu edhe siç është pritur, shumica dërmuese e farmacistëve mendon që pronari i barnatores duhet të jetë farmacist ndërsa një pjesë shumë e vogël ka mendim të kundërt për këtë çështje. Në shumë shtete ka një situatë monopolit në të cilën vetëm farmacistët lejohen që të mund të hapin apo të licencojnë barnatore Philipseen dhe Faure (2002).

Gjatë hulumtimit tone vërehet se rreth 90% e farmacistëve mendojnë se duhet të ketë një distancë të caktuar me ligj si kriter për hapjen e barnatoreve të reja. Dominon mendimi se largësia minimale në mes të barnatoreve duhet të jetë 500 m, megjithëse ka shumë metoda se si kjo është zgjidhur në vende të ndryshme të Europës. Në artikullin nga Philipseen dhe Faure (2002) theksohet se për të hapur një barnatore në Holandë duhet patjetër që kjo të bëhet vetëm nëse plotësohet kushti in jë barnatoreje në 7000 banorë, apo në Hungari 1 barnatore për 5000 banorë (Peto F me bashkëpunëtorë 2011) dhe me distancë minimum 250-300m. Gjithashtu kjo theksohet edhe në raportin nga IMS health (2008) në të cilin janë përshkruar rregullat e shteteve të ndryshme sa i përket sektorit farmaceutik në të cilat mund të shihet se në shumicën e shteteve ka rregullim të hapjes së barnatoreve sipas numrit të

popullësisë (rregullimi demografik) pastaj sipas gjeografisë (rregullimi i distancës në mes të barnatoreve), puna e barnatores në mënyrë strikte vetëm në prezencë të farmacistit dhe hapja e tyre vetëm me pronësi në shumicë të aksioneve nga farmacisti (IMS 2008). Gjithashtu ndryshime të legjislatoreve po ndodhin edhe në vende tjera në Europë psh në Poloni me ligjin e ri të amandamentuar (Ligji i ri Polak 2017) ku është përcaktuar që një barnatore të hapet në 3000 banore dhe me distancë së paku 500m, ngjashëm është edhe në Kroaci me përcaktim demografik dhe gjeografik (udhëzimi Kroat për themelimin e barnatoreve)

Mbi 2/3 e farmacistve kanë njohuri për udhëzimin administrativ për importin e produkteve joparalele të regjistruara në Kosovë.

Gjithashtu, shumica e farmacistëve, mbi 2/3 e tyre mendojnë se barnat e regjistruara në Kosovë nuk i përmbushin nevojat e tregut. Kjo e dhënë nga përditshmëria e punës së farmacistëve komunitarë duhet sinjalizojë personat adekuat që kujdesen për furnizimin me barna të qytetarëve të Kosovës.

Pjesa më e madhe e farmacistëve mendon se kriter për licencimin e barnatoreve komunitare duhet të jenë së paku 2 farmacistë. Në këtë mënyrë do të kontribuohet në rritjen dhe cilësinë e shërbimeve farmaceutike në barnatoret komunitare.

Mendimi i farmacistëve është i ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë sa i përket kriterit për licencim të nevojës apo jo të teknikut të farmacisë. Një pjesë pak më e madhe e farmacistëve mendon se shërbimet e teknikut të farmacisë nuk janë të domosdoshme.

Studimi jonë tregon se çmimi zyrtar i produkteve medicinale (çmimi në banderolë) është i domosdoshëm. Shumica absolute e farmacistëve janë shprehur pozitivisht për çmimin në banderole të produkteve farmaceutike.

Pjesa më e madhe e farmacistëve nuk kanë asgjësuar barna dhe nuk janë të informuar me procedurat e asgjësimit të barnave. Kjo e dhënë duhet të vëjë në veprim IF I cili duhet që jo vetëm të njoftojë farmacistët komunitarë për këto procedura por edhe të kontribuojë në rekomandimin e procedurave standard për asgjësimin e barnave.

Gjatë punës profesionale në barnatore, problem kryesorë për farmacistët ko-

munitarë janë çmimet jostabile të barnave, pastaj e barnave dhe mungesa e recetës.

Në hulumtimin tonë përveç problemeve të cekura, mungesa e recetës për barna psikotrope dhe narkotik është një problematikë që është evidentuar nga më shumë se 90% e farmacistëve.

Sa i përket Shërbimeve të ofruara nga depot farmaceutike, opinion i farmacistëve është i ndarë pothuajse në mënyrë të barabartë, ku pak më shumë se gjysma janë të kënaqur me këto shërbime.

Pjesa dërmuese e farmacistëve që kanë marrë pjesë në hulumtim janë të mendimit se përgjegjës për licencimin e barnatoreve komunitare duhet të jetë OFK. Deri më tani licencimin e barnatoreve në Kosovë e bënë AKPPM.

Nga përgjigjet e farmacistëve që kanë marrë pjesë në hulumtim shihet shihet se një numër i madh i farmacistëve në Kosovë mendon se problemet që janë cekur në këtë hulumtim janë shqetësimet aktuale me të cilat përballet sot komuniteti farmaceutik (Barnatoret Komunitare).

VI. Përfundimet

Si rezultat i këtij hulumtimi dhe gërshetimit të të dhënave të fituara, kemi ardhë në përfundim se:

- » Shumica e farmacistëve janë të të kënaqur me shërbimet e ofruara nga OFK.
- » Shumica e farmacistëve nuk janë të të kënaqur me shërbimet e ofruara nga AKPPM. (megjithëse vlen të theksohet se prej anketimit në Nëntor 2018 dhe deri në përgatitjen e këtij publikimi Qershor 2019 ka pasur rezultate konkrete në përmirësimin e shërbimeve të ofruara).
- » Më shumë se gjysma e farmacistëve kanë shprehur kënaqësi me shërbimet e ofruara nga MSH (Ministria e Shëndetësisë), gjegjësisht me punën e Inspektoriatit Farmaceutik (IF)
- » Rreth 2/3 e farmacistëve kanë vështirësi me procedurat e licencimit të barantoreve komunitare nga organet kompetente të AKPPM-së. Vështirësia kryesore e cila theksohet është lartësia e taksës vjetore apo akreditimi vjetor.
- » Pezullimi i licencës së barnatores nga ana e organeve të AKPPM-së është jo i drejtë përshkak të vonesës së apikimit për vetëm edhe një ditë.
- » Farmacistët janë relativisht të kënaqur me kriteret e përcaktuar sipas Udhëzimit administrativ 11/2015 në lidhje me licencimin e barnatoreve komunitare.
- » Pronar i barnatores komunitare duhet të jetë vetëm farmacisti.
- » Duhet të përcaktohet me ligj distancë në mes të barnatoreve komunitare (500 m).
- » Farmacistët kanë njohuri për udhëzimin administrativ për importin e produkteve joparalele të regjistruara në Kosovë.
- » Barnat e regjistruara në Kosovë nuk i përmbushin nevojat e tregut.
- » Si kriter për licencimin e barnatoreve komunitare duhet të jenë 2 farmacistë.

- » Nuk përcaktohet saktësisht se a duhet apo jo që tekniku i farmacistë të jetë kriter për licencimin e barnatoreve komunitare.
- » Produktet farmaceutike duhet të kenë çmim zyrtar (çmim në banderolë).
- » Farmacistët nuk kanë asgjësuar barna me afat të skaduar dhe nuk kanë njohuri për procedurat e asgjësimit të barnave me afat të skaduar.
- » Gjatë punës profesionale në barnatore problem kryesor dhe shqetësues janë çmimet jostabile të barnave.
- » Gjatë punës profesionale në barnatore, mungesa e recetës për barna psikotrope dhe narkotike paraqet problem.
- » Farmacistët janë relativisht të kënaqur me shërbimet e ofruara nga depot farmaceutike.
- » Përgjegjëse licencimin e barnatoreve komunitare duhet të jetë OFK.
- » Ky hulumtim i ka përfshirë në mënyrë të kënaqshme problemet aktuale me të cilat përballlet sot komuniteti farmaceutik (Barnaret Komunitare)



VII. Referencat

4. Ligji për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë
5. Statuti i Odës së Farmacistëve të Kosovës
6. Ligji për produkte dhe pajisje medicinale (Ligji Nr. 04/L -190)
7. Ligjin për Sigurimet Shëndetësore në Kosovë (2013/04-L-249)
8. <http://ofk-rks.net/>
9. Ligji Nr. 04/L-125 për shëndetësi.
10. Analiza e produkteve të listës esenciale për vitin 2013 sipas VEN dhe ABC indikatorëve.
11. Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e qytetarëve në kujdesin shëndetësorë (Ligji Nr.2004/38)
12. Ligji për veprimtarinë private në shëndetësi (Ligji nr.2004/50)
13. Ligji për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë (Ligji Nr. 02/L-128)
14. Udhëzimi administrativ (Shëndetësi) Nr. 14/2013 për qarkulluesit me pakicë për produkte dhe pajisje medicinale.
15. Ligji për farmaci (2017) amending the Pharmaceutical Law (the “Amending Act”), in Poland.
16. Pravilnik (2016) Licencimi i barnatoreve në Kroaci.
17. Udhëzimi administrativ (Shëndetësi) Nr. 02/2014 për thjeshtësimin e procedurave për regjistrimin e produkteve medicinale të cilat nuk kanë paralele të regjistruara në Republikën e Kosovës.
18. Udhëzimi administrativ (Shëndetësi) Nr. 04/2017 për ndryshimin dhe plotësimin administrative Nr. 04/2016 për tarifat e shërbimeve të ofruara në AKPPM.

19. Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
20. AKPPM (2019) barnatoret e licencuara në Kosovë. E qasshme nga <https://akppm.com/en/category/publikimet/barnatoret-e-licencuara/>, 26.06.2019.
21. IMS (2008) Pricing and reimbursement in Western Europe.
22. IMS (2008) Pricing and reimbursement in Cendtral and Eastern Europe.
23. Philipseen dhe Faure (2002) The Regulation of Pharmacists in Belgium and the Netherlands: In the Public or Private Interest? *Journal of Consumer Policy*. 25(2), p. 155–201
24. Peto F, Juan V, Borbala S (2011) Changing winds in the Hungarian pharmaceutical market Analysis of the changes in the regulatory framework. Barcelona Graduate School of Economics.

VIII. Shtojca 1 – Anketa

REPUBLIKA E KOSOVËS

Republika Kosovo - Republic of Kosovo

ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS

Komora Farmaceuta Kosova

Kosova Chamber of Pharmacists

Komisioni i OFK-së për barnatore komunitare

1. A jeni të knaqur me shërbimet e ofruara nga OFK

PO

JO

2. A jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara nga AKPPM

PO

JO

3. A jeni të knaqur me shërbimet e ofruara nga MSH (ministria e shëndetësisë), gjegjësisht me punën e Inspektoriatit Farmaceutik

PO

JO

4. A ju paraqesin vështirësi procedurat e licencimit të Barantoreve komunitare nga organet kompetente të AKPPM-së.

Po

Jo

Nëse PO, në cilat procedura mendoni se keni veshtirësi:

- Dëshmia e pronësisë së lokalit (kontrata qiramarrje/qiradhënie),
- Hapsirat e lokalit (p.sh sipërfaqja, lartësia),
- Lartësia e Taksës vjetore, Akreditimi Vjetor

5. A mendoni se pezullimi i licencës së barnatores nga ana e organeve të AKPPM-së është i drejtë për shkak të vonesës së apikimit për vetëm edhe një ditë.

- PO
- JO

6. A jeni të kënaqur me kriteret e përcaktuar sipas Udhëzimit administrativ 11/2015 në lidhje me licencimin e barnatoreve komunitare.

- PO
- JO

7. A mendoni se pronar i Barnatores Komunitare duhet të jetë vetëm Farmacisti

- PO
- JO

8. A mendoni se duhet të jetë një distancë e caktuar me ligj (Udhëzim Administrativ) si kriter për licencimin e Barnatoreve Komunitare

- PO
- JO

Nëse PO, sa mendoni se duhet të jetë distance nga Barnatoret ekzistuese

- 100 m
- 300 m
- 500 m

9. A keni njohuri për udhëzimin administrativ për importin e produkteve joparalele të regjistruara në Kosovë

- PO
- JO

10. A mendoni se barnat e regjistruara në Kosovë i përmbushin nevojat e tregut

- PO
- JO

11. A mendoni se kriter për licencimin e Barnatoreve Komunitare duhet të jenë 2 farmacistë

- PO
- JO

12. A mendoni se kriter për licencimin e Barnatoreve Komunitare duhet të jetë tekniku i farmacisë

- PO
- JO

13. A mendoni se duhet të ketë çmim zyrtar te produkteve medicinale (çmimi në banderolë)

- PO
- JO

14. A keni asgjësuar barna me afat të skaduar.

- PO
- JO

15. A jeni të informuar me procedurat e asgjësimit të barnave me afat të skaduar.

- PO
- JO

16. Gjatë punës profesionale në Barnatore, cilat nga problemet ju shqetësojnë:

- Çmimet jostabile të barnave
- Mungesa e barnave
- Mungesa e recetës

17. Gjatë punës profesionale në Barnatore, a ju paraqet problem mungesa e recetës për psikotrope dhe narkotik.

- PO
- JO

18. A jeni të kënaqur me shërbimet e ofruara nga depot farmaceutike

PO

JO

19. Kush mendoni se duhet të jetë përgjegjës për Licencimin e Barnatoreve Komunitare

AKPPM (Agjencioni Kosovar për Produkte dhe Paisje Medicinale),

OFK (Oda e Farmacistëve të Kosovës)

20. A mendoni se ky pyetësor i ka përfshirë në mënyrë të kënaqshme problemet aktuale me të cilat përballet sot Komuniteti Farmaceutik (Barnatoret Komunitare)

PO

JO

Nëse JO, luteni që t'i prezentoni problemet që nuk janë përfshirë në këtë pyetësor

KOMENT: _____

